



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:243821
Datë: 11.07.2024
Numri i dokumentit: 05929226

Në ankesën e

AC-I-23-0249

Paditësja/ankuesja

Kompania e Ujësjetës, Rajonal "Prishtina" SH.A, Prishtinë.

kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami, gjyqtar, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1095 të datës 18 prill 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 11 korrik 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditëses refuzohet si e pa bazuar**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-15-1095 i datës 18 prill 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 18 qershor 2015, paditësja e ka dorëzuar në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN029-0186 të datës 11 qershor 2015, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e paditëses e cila kishte kërkuar kompensimin për fatura të pa paguara, për borgjin e ujit dhe kanalizimit në shumë prej 59,110.21 euro, nga kërkesa e përgjithshme prej 62,605.56 euro me arsyetimin se ky borgj nuk është argumentuar, është parashkruar. Paditësja pohoi se e paditura refuzoi kërkesën e saj në shumë prej 59,110.21 euro edhe përkundër faktit se kërkesa është parashtruar në lartësi prej 62,605.56 euro, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në kuptim të nenit 374 të LMD-ë 1978. Po ashtu paditësja pohoi se e paditura nuk ka të drejte që zyrtarisht të deklarohej në lidhje me parashkrimin edhe kur ai ekziston pasi që është organ që vendos çështjen dhe me këtë bie në , kundërshtim me nenin 360 par.3 të LMD-së ku thuhet” nuk mund të përfillet zyrtarisht parashkrimi nga organi që e vendos çështjen nëse atë nuk e ka invokuar vet debitori”. Më tej paditësja pohoi se është e pa qarte se mbi cilën bazë ligjore e paditura sipas detyrës zyrtare e konstaton parashkrimin në kundërshtim me dispozitën nenit 360.3 të LMD-së, dhe se e paditura sipas nenit 5 të Ligjit për AKP-në nr.04/L-034 ka kompetencë ekskluzivë që të administroi ndërmarrjet në pronësi shoqërore dhe se mbështetur në këtë dispozite zbatimi i nenit 374 i LMD-së nga e paditura në kundërshtim me nenin 360.3 e jep me kuptua se e paditura është e një anshme. Paditësja i ka propozuar Gjykatës që ta anulojë vendimin e kundërshtuar dhe ta aprovoje kërkesën si te themeltë. Në mbështetje te padisë dorëzoi: vendimin e kundërshtuar dhe formularin për parashtrimin e kërkesës jo pronësorë në likuidim me nr.33984/2014, datë 11 gusht 2014.

Më 13 shtator 2017, e paditura AKP parashtrroi mbrojtje në të cilën pohoi se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se paditësja konsideron se është e rëndësishme te theksohet se objekt i kësaj procedurë

është vetëm ligjshmëria dhe neni 70.2 i Shtojcës së Ligjit 04/L-033 parasheh që padia e dorëzuar në DHPGJS, kundër vendimeve të AL-së duhet te bazohen ne pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me ligjin 04/L-034 për AKP-në. Po ashtu e paditura pohoi se paditësja nuk ka ofruar ndonjë argument ligjor në mbështetjeje të padisë se saj dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 27.2.4 të Shtojcës se Ligjit 04/L-033, i cili parasheh që një " ankesë duhet të përmbajë "(...) argumentet ligjore mbi të cilat mbështetet ankesa". Më tej e paditura pohoi se pjesa më madhe e shumës së pretenduar nga paditësja është refuzuar nga AL, për shkak se ajo lidhet me një subjekt tjetër e jo me ndërmarrjen dhe se shuma prej 46,832.61 euro që lidhet me fatuen #321 është refuzuar sepse ajo rezulton të jetë konsumuar nga subjekti N.T.P I K (e cila sipas kontratës së koncesionit të datës 01 nëntor 2001, neni VIII, pika G parashikon se pas hyrjes në fuqi të kontratës, pra për periudhën 2002-2007, subjekti N.T.P I K është e detyruar të përmbush të gjitha detyrimet), andaj, nuk janë detyrim i NSH-së dhe paditësja këtë shumë duhet të pretendoi nga ky subjekt. Po ashtu e paditura pohoi se neni 36.2.1 i Shtojcës se Ligjit nr. /L-034 parasheh se "elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: 2.1 kërkesa apo pretendimi është i pas afateshëm sipas kufizimeve kohore të Aplikueshme" si dhe neni 374 të LMD-së i cili parasheh që afati i parashkrimit për kërkesa që kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime është 3 vjet nga koha kur NSH nuk e ka përmbushur obligimin ndaj paditëses, pretendimet e paditëses konsiderohen të parashkruara para vitit 2011, sepse paditësja ka mundur të ndërmarra një veprim juridike për përmbushjen e pretendimeve të tij. E paditura propozoi që padija të refuzohet si e pa pranueshme ose e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar. Në mbështetje te mbrojtjes se tij e paditura dorëzoi Ekstraktin nga kontrata e koncesionit (faqet 15-16 te dosjes se lendes) dhe kërkesën e datës 16 gusht 2016 për emërimin e anëtareve në AL.

Më 02 tetor 2017, paditësja e dorëzoi përgjigjen në mbrojtje.

Më 25 tetor 2017, e paditura dorëzoi kundërpërgjigje në përgjigjen e paditëses.

Më 24 korrik 2019, gjykata ka kërkuar nga paditësja që të parashtrojë kartelën e konsumatorit- faturën nr.#321 dhe#1460 si dhe dëshmi të tjera në mbështetje të ankesës së saj.

Më 20 gusht 2019, paditësja është përgjigjur në urdhrin e gjykatës duke dorëzuar provat e kërkuara: ekstraktet nga librat e Konsumatorit dhe ato të Kontabilitetit: për periudhat 2002-2003, 2003-2004, 2004-2005, 2006-2006, 2006-2014, Kartelën financiare të konsumatorit #321, 01 janar 2013-20 gusht 2019, Ekstraktet nga Librat e kontabilitet: për periudhat 2006-2014, 2006-2006, 2004-2005, 2003-2004, 2002-2003 dhe kartelën financiare të konsumatorit #1460, 01 janar 2013 - 20 gusht 2019.

Më 27 janar 2020, e paditura është përgjigjur në urdhrin e gjykatës lidhur me parashtresën e datës 20 gusht 2019, duke dorëzuar kontratën e koncesionit mes NSH-së dhe NTP " I K". Përgjigjen e propozimit të Z. A Sh , në shkresat e datës 25 shtator 2002 si dhe Letrën e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit drejtuar drejtoreve të IMN Kosova dhe I K.

Me 18 prill 2023, Shkalla e I-re e DHPGJS-së, ka marre Aktgjykim C-IV-15-1095, me të cilin refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe vërtetohet vendimi i autoritetit të Likuidimit PRN029-0186 datë 11 qershor 2015, si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se me vjetërsimin/ parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërkimit të përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën pas ditës kur kreditori të këtë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Në rastin konkret e drejta për të kërkuar kompensimin për borxh të pa paguar është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që paditësja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar për të kërkuar borxhin e pretenduar dhe

kështu për ta ndalur rrjedhën e aftit të parashkrimit. Tutje Shkalla e I-rë ka arsyetuar se në shkresat e lendes rrjedh se paditësja kërkesën për faturat e pa paguara për furnizimi me ujë për dy njësi të ndryshme të NSH" IMN" për periudhën nga viti 2002 deri në vitin 2014 , në shumë totale prej 62,605.56 e ka parashtruar tek Autoriteti i likuidimit më 11 gusht 2014 dhe e vetmja pjesë e borgjit që nuk është parashkruar është borgji për periudhën e tre viteve të fundit (11 gusht 2011-11 gusht 2014) për të dy njësitë e NSH-së e që është borgji në shumë 3,495.35 euro, shumë e cila është e aprovuar nga AL, ndërsa pjesa e mbetur e shumës së kërkuar për periudhën para 3 viteve të fundit, në shumën prej 59,110.21 euro në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura del se çdo borgj para datës 11 gusht 2011, ishte parashkruar dhe kërkesa e tillë me të drejtë është refuzuar nga AL.

Shkalla e I-rë gjithashtu kishte vlerësuar se më të drejtë AL kishte gjetur se një pjesë e borgjit nuk i përket NSH-së por një subjekti tjetër përkatësisht N.T.P " I K", kjo pasi subjekti në fjalë kishte marrë në koncesion asetet e NSH-së dhe sipas Kontratës së Koncesionit të datës 01 nëntor 2001, neni VIII, pika G, marrësi apo subjekti në fjalë ishte obliguar që prej hyrjes në fuqi të kontratës, të paguajë në kohë të gjitha shërbimet dhe shpenzimet e tjera që vijnë pas datës së hyrjes në fuqi të kontratës, deri në muajin qershor 2007, prandaj AL me të drejtë nuk e refuzoi në tersi kërkesën si të parashkruar.

Shkalla e I-rë ka konstatuar se paditësja me parashtrimin e ankesës kundër vendimit të AL-së, nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të bënin ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përket parashkrimit të se drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore borxhin e pa paguar dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të ankimuar. Po ashtu, paditësja nuk ka paraqitur ndonjë provë për të dëshmuar faktin se ka iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore, se ka parashtruar kërkesë për borxhin e pretenduar pranë organeve kompetente para ushtrimit të kërkesës tek AL. Sa i përket pretendimit të paditëses se AKP-ja, AL-ja nuk ka të drejtë që zyrtarisht të deklarohej në lidhje me parashtrimin, Shkalla e I-rë e ka konsideruar si të pa bazuar, pasi që AL-ja nuk e ka rolin e gjykatës, por është organ i vendimmarrjes dhe konform dispozitës së nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 të AKP-së ka pasur që ta refuzojë kërkesën edhe mbi bazën e parashtrimin të vonuar të parashkruar të së njëjtës.

Me 03 maj 2023, paditësja/ ankuesja e dorëzon në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-15-1095 të datës 18 prill

2023. Në ankesën e parashtruar paditësja e kundërshton aktgjykimin e atakuar dhe thekson se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me parashkrim sepse debitori vazhdimisht ka bërë pagesë në emër të ujit dhe në këtë rast e ka pohuar borxhin që e ka ndaj paditëses, Neni 373 i LMD.

Pretendimet e debitorit në lidhje me parashkrimin e borxhit nuk janë të qëndrueshme në kuptim të dispozitave të nenit 368 të LMD që normohen 1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veq se edhe në mënyre të tërthortë, sikurse janë pagesat e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit. Dhe në bazë të Ekstraktit vërtetohet se debitori ka bërë pagesa në emër të Ujit. Paditësja/ankuesja në ankesën e parashtruar konsideron se Aktgjykimi është i pa bazuar sepse gjatë periudhës për të cilën paditësi e kërkon borgjin, qirimbajtëse apo shfrytëzues të objektit të NSH. IMN Kosova ka qenë N.T.P Ital Kosova të cilën e pohon vete e paditura në vendimin kur e ka refuzuar kërkesën e paditësit mirëpo pronare të objektit ka qenë e paditura IMN Kosova dhe të gjitha detyrimet e pa paguara nga qiramarrësit apo shfrytëzuesit duhet ti paguajë pronari, në këtë rast IMN Kosova. Për paditësen nuk është e rëndësishme se si kanë qenë të rregulluara raportet në mes të paditurës dhe N.T.P I K në kuptim të përmbushjes se detyrimeve ndaj paditësit për ujin dhe shërbimet e shfrytëzuara të paditësit por për paditësen është e rëndësishme se meqë shfrytëzuesi i objektit nuk i ka paguar detyrimet ndaj paditësit, ato duhet ti paguajë pronari i objektit, për këtë rast IMN Kosova sepse shërbimet e paditësja i kishte ofruar objektit me pronësi të paditurit. I ka propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS që ta aprovoj ankesën e paditësit si të bazuar.

Me 05 mars 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen ndaj ankesës. Në këtë parashtrësë AKP-ja ka pohuar se argumentet e veta qartësisht i ka sqaruar në mbrojtjen në ankesë, andaj përsëritja e tyre do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditëses është pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditëses e paraqitur tek AL me datës 11 gusht 2014, për kompensimin e kompensimin për fatura të papaguara, për dy njësi të ndryshme të NSH "IMN Kosova", në shume totale prej 62,605.56 euro është:

Pranuar në shumën prej 3,495.35 euro, në përputhje me nenin 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 për AKP-në, ndërsa është refuzuar shuma prej 59,110.21 euro, me arsyetimin se pjesa e borgjit për periudhën nga 01 nëntor 2001 deri në qershor 2007 nuk i takon të paditurës por është detyrim i N.P.T I K pasi që kësaj të fundit asetet i ishin dhënë me koncesion deri në muajin qershor 2007, kurse pjesa tjetër është refuzuar për shkak të parashkrimit.

Shkalla e I-re e DHPGJS-së, kishte marrë Aktgjykim C-IV-15-1095, me të cilin e ka refuzuar si e pa bazuar ankesën e paditëses dhe ka vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN029-0186, të datës 11 qershor 2015, si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Paditësja/ankuesja nuk pajtohet me aktgjykimin e shkallës së I-rë dhe e kundërshton me ankesë pranë Kolegjit të Apelit për shkak se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me parashkrim sepse debitori vazhdimisht ka bërë pagesë në emër të ujit dhe në këtë rast e ka pohuar borxhin që e ka ndaj paditëses, Neni 373 i LMD. Thekson se pretendimet e debitorit në lidhje me parashkrimin e borxhit nuk janë të qëndrueshme në kuptim të dispozitave të nenit 368 të LMD që normohen 1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin.2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veç se edhe në mënyre të tërthortë, sikurse janë pagesat e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit. Dhe në bazë të Ekstraktit vërtetohet se debitori ka bërë pagesa në emër të Ujit.

Kolegji i Apelit i ka shqyrtuara dhe vlerësuar pretendimet ankimore, mirëpo nuk ka gjetura se ka shkelje, prandaj nuk mund të pajtohet me pretendimet e paditëses, pasi që të njëjtat nuk janë të argumentuara dhe nuk janë të mbështetura në Ligj.

Shkalla e I-rë ka vlerësuar provat e ofruara nga palët ndërgjyqëse dhe ka marr aktgjykim i cili sipas vlerësimit të Kolegjit të Apelit është i drejtë dhe i bazuar në Ligj. Kjo pasi që Shkalla e I-rë ka dhënë arsye konkrete për faktet vendimtare duke dhënë shpjegime dhe arsyet adekuate dhe të bazuar në dispozita ligjore që i referohen kësaj çështje juridike.

Kolegji i Apelit i mbështet si të saktë konstatimet e Shkallës së I-rë se pjesa e borgjit që nuk është parashkruar është borgji për periudhën e tre viteve të fundit 11 gusht 2011- 11 gusht 2014, për të dy njësitë e NSH-së të cilën e kishte pranuar edhe AL në shumë 3,495.35 euro, ndërsa pjesa e mbetur e shumës së kërkuar për periudhën para 3 viteve të fundit, në shumën prej 59,110.21 euro, është parashkruara në bazë të dispozitave ligjore përkatësisht nenit 374 të LMD ose (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr.29/1978, si Ligji i zbatueshëm në kohën kur pretendohet se është krijuar detyrimi, e i cili parash që "kërkesat e ndërsjellat të personave juridike ..." vjetërsohen për 3 vite. Të njëjtat rregulla parasheh edhe nenin 355 të LMD-së (Ligji nr.04/L-077, Ligji i zbatueshëm në kohën e marrjes së vendimit). Andaj në baza të këtyre dispozitave Ligjore del se çdo borgj para datës 11 gusht 2011, ishte parashkruar dhe kërkesa e tillë me të drejtë është refuzuar nga Shkalla e I-rë e DHPGJS.

Pretendimet e paditëses se parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin.2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veç se edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesat e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit. Është e vërtetë se parashkrimi ndërpritet siç parasheh ligji, por jo dhe tek ky rast që është objekt i shqyrtimit pasi që pagesat e bërë nuk janë bërë në kuadër të ndonjë marrëveshje të nënshkruar paraprake të lidhure në mes të paditëses dhe të paditurës që përfshin pagesën e kisteve, e cila do qonte në ndërprerje të parashkrimit, andaj për këtë arsye pretendimi i paditëses se ka pasur ndërprerjeje të parashkrimit janë të pabazuara.

Kolegji i Apelit po ashtu vlerëson se Shkalla e I-rë, ka konstatuar në mënyrë të drejtë se pjesa e borgjit për periudhën 2002 deri 2007, nuk i përket NSH-së "IMN Kosova", por një subjekti tjetër përkatësisht N.T.P " I K", kjo pasi subjekti në fjalë kishte marrë në Koncesion asetet e NSH-së "IMN Kosova" dhe sipas Kontratës së Koncesionit të datës 01 nëntor 2001, neni VIII, pika G, marrësi apo subjekti në fjalë ishte obliguar që prej hyrjes në fuqi të kontratës, të paguajë në kohë të gjitha shërbimet dhe shpenzimet e tjera që vijnë pas datës së hyrjes në fuqi të kontratës, deri në muajin qershor 2007, prandaj edhe pretendimet e paditëses se paditura është pronare e objektit dhe ajo ka për detyrim ta përmbush borgjin ndaj paditëses është i pa bazuar.

Paditësja edhe në procedurë të ankesës pran Kolegjit të Apelit nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të bënin ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përketë parashkrimit të së drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore borxhin e pa paguar dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar. Paditësja nuk ka paraqitur ndonjë provë për të dëshmuar faktin se ka iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore, se ka parashtruar kërkesë për borxhin e pretenduar pranë organeve kompetente para ushtrimit të kërkesës tek AL.

Prandaj nga këto arsyeje ankesa e paditëses/ankuese refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet aktgjykimi i ankimuara si të drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Paditësja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 12 qershor 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 11 korrik 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues _____